

KËRKIME GJUHËSORE

Vjosa OSMANI

KOHEZIONI GRAMATIKOR NË ROMANET E ISMAIL KADARESE

Hyrje. Tekstet e Kadaresë shquhen për veçori të shumta pothuajse në të gjitha fushat e shqipes, në sintaksë, në frazeologji, në fjalëformim etj. Kadareja shquhet për stilin e vet në përdorimin e mjeteve të ndryshme gjuhësore qoftë për efekte stilistike, por edhe për “arkitekturën” e tekstit.

Së këndejmi, teksti letrar dhe gjuha në veprat e Kadaresë ka gjetur një trajtim studimor, monografik për aspekte të veçanta apo të përgjithshme në këtë drejtim.

Megjithatë, deri më tani nuk është bërë një studim i mirëfilltë dhe i plotë gjuhësor që del jashtë kufijve të fjalisë për veprën e këtij autori. Prandaj, ky punim është një përpjekje për të trajtuar pikërisht mënyrën se si ndërtohen gjuhësisht tekstet e tij, apo si realizohet lidhja gramatikore midis njësive gjuhësore. Thënë më saktësisht, korpusin e hulumtimit tonë e përbën studimi i lidhjes kohezive gramatikore në tekstet e Kadaresë.

Gjatë studimit kemi pasur parasysh disa synime:

1. Të hulumtohen format dhe mënyrat e lidhjeve tematike në veprën e Kadaresë.
2. Të hulumtohen mjetet e lidhjes.
3. Të klasifikohen mjetet e lidhjes.
4. Të analizohen si zgjedhje.

Vështrimi ynë ka pasur për qëllim të vërtetojë pohimin, të ngritur qysh në fillim, se tekstet e Kadaresë shquhen për përdorimin e mjeteve të ndryshme gjuhësore, qoftë për efekte stilistike, por edhe për “arkitekturën” e tekstit.

Laramania e mjeteve kohezive rrjedh nga laramania e tipave të ligjëritimit. E meqenëse tekstet e Kadaresë jo vetëm që nuk ndërtohen mbi bazën e një tipi të vetëm e homogjen, por karakterizohen nga struktura mjaft komplekse kompozicionale dhe ligjërimore, ku narracioni, rrëfimi paralel, komentues e dokumentar, përshkrimi, dialogu dhe forma të tjera ligjërimore dalin si forma të përdorura dendur, përdorimi i mjeteve të ndryshme gjuhësore për lidhjen e sekuencave të tilla është mjaft i larmishëm dhe e shquan atë gjatë ndërtimit të tekstit. Lidhja nuk bëhet në kufij të fjalisë, por vepron jashtë saj, duke luajtur rol të rëndësishëm në organizimin e tekstit.

Kohezioni gramatikor. Kohezioni gramatikor ka të bëjë me përdorimin e mjeteve gramatikore për të lidhur mes vete njësi të ndryshme të tekstit.

Lidhja gramatikore në mes të fjalive, paragrafëve, apo sekuencave, realizohet përmes zëvendësimit, fjalëve referenciale, lidhëzave e mjeteve të tjera kohezive gramatikore.

1.1 Zëvendësimi është një nga tipat e kohezionit gramatikor, i cili realizohet kur brenda një teksti një njësi e caktuar, fjalë apo fjali e tërë, zëvendësohet me një njësi tjetër apo me një njësi zero që njihet si elipsë.

Ky tip i kohezionit paraqet një marrëdhënie gramatikore kështu që llojet e ndryshme të zëvendësimit përcaktohen më shumë nga ana gramatikore sesa semantike¹.

Në gjuhën shqipe zëvendësimi mund të jetë disa llojesh:

- Zëvendësimi i emrave, apo i fjalive të tëra me përemra
- Zëvendësimi i foljeve ose fjalive të tëra me pjesëzat *po* dhe *jo*
- Zëvendësimi i fjalive të tëra me ndajfolje të mënyrës (*ashtu, kështu*)

Zëvendësimi është një nga tipat më të shpeshtë koheziv në tekstet e Kadaresë. Përmes këtij tipi koheziv realizohet jo vetëm një stil i veçantë, por edhe një strukturë tekstore mjaft interesante.

Tipi mbizotërues është zëvendësimi i emrave, apo i fjalive të tëra me përemra. P.sh.: *Disa miq të tij e këshilluan të mos merrte, sepse femra në luftë është ters. Të tjerët i thanë të kundërtën.* (“Kështjella”, f. 10)

Zëvendësimi i fjalive të tëra me ndajfoljet e mënyrës *ashtu* dhe *kështu* është po ashtu i dendur. P.sh.: *Thonë se këto armë të reja do të ndryshojnë këndeje e tutje natyrën e luftës dhe do të nxjerrin jashtë përdorimit kështjellat-tha kronikani.*

Ashtu flitet. (“Kështjella”, f. 32)

Në tekstet e Kadaresë e hasim mjaft shpesh edhe zëvendësimin me elipsë. P.sh.: *Dolëm përjashta në sheshin e madh. Ishte ftohtë.* (“Kronikë në gur”, f. 153)

Në këtë rast kemi zëvendësim me elipsë, meqenëse në fjalinë e dytë mungon ndajfolja e vendit *aty*. Zëvendësimin me elipsë e hasim sidomos në sekuencat e dialogut. Në këtë tip ligjërimi, zëvendësimi me elipsë përdoret me qëllim që të arrihet fuqi në shprehjen e qëndrimeve përkatëse kuptimore, të bëhet shkrimi më tërheqës dhe të përshpejtohet zhvillimi i rrëfimit. P.sh.:

- *Domethënë ti nuk e ke parë asgjëkund në lagje?*
- *Asgjëkund.*
- *Asnjëri s’e ke parë?*
- *Asnjëri.*
- *A ka shumë puse në lagjen tuaj?*
- *Ka disa* (“Kronikë në gur”, f. 154)

Për t’u arritur një qëllim i tillë, përdoret shpesh edhe pjesëza mohore *jo* dhe pjesëza pohore *po*. P.sh. *Kjo fushatë do të mbaronte dhe sido që të mbaronte ajo, ata do të vazhdonin karrierën e tyre, do të niseshin prapë nëpër marshime, do t’i ngrinin prapë çadrat përpara kështjellave të panjohura, do të ngjiteshin e do të zbritnin e prapë do të ngjiteshin në shkallët e hierarkisë shtetërore apo ushtarake. Kurse ajo jo.* (“Kronikë në gur”)

Siç shihet, ky tip koheziv përdoret me qëllim që mendimi të shprehet më shkurt, por gjithsesi pa e vështirësuar kuptimin. Në këtë rast fjala merr përsipër të shënojë një situatë a veprim të tërë. Megjithëse njësia mungon, domethënia e tërësisë mund të kuptohet në kontekst të situatës.

¹ Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave*, Koha, Prishtinë, 2009, f. 239.

1.2 Referenca është një nga tipat e kohezionit gramatikor, e cila, ndryshe nga zëvendësimi, ka të bëjë me marrëdhëniet semantike midis njësive gjuhësore.

Sipas Hollyday-it dhe Hassan-it², në çdo gjuhë ka disa njësi të caktuara gjuhësore të cilat nuk kanë mundësi të interpretohen semantikisht vetvetiu, kështu që i referohen një njësie tjetër për interpretimin e tyre. Kohezioni fshihet në vazhdimësinë e referencës, me ç'rast e njëjta njësi hyn në ligjërim për të dytën herë³. Përdoret për t'ju referuar, qoftë elementeve që gjenden të shprehura brenda tekstit (referenca endoforike), qoftë elementeve që nuk gjenden të shprehura drejtpërsëdrejti brenda tekstit, por që për interpretimin e tyre duhet t'i referohemi kontekstit situativ (referenca ekzoforike).

Në tekstet e Kadaresë lidhja kohezive nëpërmes njësive referenciale është mjaft e shpeshtë. Në kontekstin situacional shfrytëzohen mjetet përkatëse të situacionit, si: përemrat vetorë: *unë, ti, ne* dhe *ju*, si dhe elementet gjuhësore që dalin në funksione kohore. Në këtë funksion përdoren elementet kohore: *dikur, tani, atëherë*, e ndonjë tjetër, të cilat kanë përdorim të dendur dhe funksion të caktuar për ndërtimin e këtij tipi të tekstit dhe bashkë me të edhe të kontekstit.

Përemrat vetorë të vetës së parë njëjës dhe shumës: *unë* dhe *ne*, si dhe përemrat e vetës së dytë njëjës dhe shumës: *ti* dhe *ju* përdoren kryesisht pa iu referuar ndonjë njësie. P.sh.:

- *Unë i ngatërroj vazhdimisht ato që kemi parë.*
- *Sepse tani e bëjmë rrugën së prapthi.*
- *Veç kësaj, tani e bëjmë rrugën në heshtje.*
- *Ju kujtohet kur vinim? Ç'muzikë, ç'taborre!*
- *Të merreshin mendtë nga flamurët.*
- *Ne gjithë rrugës pyesnim: si do të jetë kjo Shqipëria? ("Kështjella", f. 244-245)*

Siç shihet nga shembulli i mësipërm, këta përemra nuk kanë një referues ndërtekstual, meqenëse nuk krijojnë lidhje brenda tekstit, prandaj janë tipik për lidhjen ekzoforike.

Përemrat vetorë: *ai, ajo, ata, ato*, si mjete për realizimin e referencës, janë të shpeshtë dhe të dendur në tekstet e Kadaresë. Përdoren zakonisht si përemra anaforik, për të mos përsëritur një emër që është zënë në gojë më parë. P.sh.: *Allejbeu foli si diplomat. Ai nuk deshi të mbante ndonjë anë dhe prandaj e spostoi pak çështjen* ("Kështjella", f. 37)

Jo rrallë këta përemra i hasim edhe përpara shprehjes bashkëreferuese. Kjo formë e referencës, që njihet si kataforë, shfrytëzohet për të shtuar interesin dhe kërkshërinë e lexuesit, me qëllim që ta motivojë në vazhdimësinë e leximit. P.sh.: *Ata fluturonin ngadalë, me krahët të shtrira dhe për një çast mua m'u duk se do të uleshin në fushën e braktisur të aeroportit, por ata papritur bënë një kthesë dhe iu drejtuan qytetit. Krahët e tyre. Shndritën kërcënueshëm në diell.*

² Halliday M.A.K., Hasan Ruqayia, *Cohesion in English*, Longman, London, 1976, f. 31

³ Bardh Rugova, *Gjuha e gazetave*, Koha, Prishtinë, 2009, 244.

Tani ishin pothuaj mbi kokat tona, pikërisht në lartësinë prej nga binin zakonisht në pikiadë. Pasi bëne një manovrim të fundit, njëri pas tjetrit u lëshuan pothuaj pingul mbi qytet.

*Kishte ardhur pranvera. Nga dritaret e katit të fundit vështroja si po vinin **lejlekët**. ("Kronikë në gur", f. 156)*

Për të realizuar aktin e referimit, përdoren dendur edhe përemrat dëftorë: *ky, kjo, këta, këto*, ndajfoljet vendore: *këtu, atje* etj., dhe ndajfoljet kohore: *tani, atëherë* etj.

Përemrat dëftore: *ky, kjo, këta, këto*, përdoren zakonisht si përemra anaforik. P.sh.: *Aeroplanët e hutuar ishin bërë kohët e fundit një gjë e zakonshme në qiellin e qytetit. **Këta** ishin avionë, që me sa duket, vinin vërdallë kot nëpër qiell.* ("Kronikë në gur", f. 123)

Ndajfoljet e vendit: *aty, këtu, atje* etj., dhe ndajfoljet e kohës *tani, atëherë* etj., i referohen njërive vendore apo hapësinore, duke u nisur nga një pikë referuese.

Për të parë se si realizohet kjo marrëdhënie në tekstet e Kadaresë po japim disa shembuj: ***Melet** ishin plot me mjegulla dimri, që rrokulliseshin greminave si në kllapi. Partizani ishte **atje*** ("Kronikë në gur" f. 174)

- *Ku jeni ju? i pyeta.*

- *Tek ajo...ajo...**atje**.*

- *Po ti*

- *tek ...kjo **këtu**.*

*Nuk e thoshim dot fjalën **shtëpi**.* ("Kronikë në gur" f. 212)

Në rastin e parë, njësia *atje*, i referohet anaforikisht njësisë *malet*, ndërsa në rastin e dytë përdoret katafora si formë e references, ku njësitë *atje* dhe *këtu* i referohen njësisë *shtëpi*, e cila vjen pas tyre.

Njësitë *tani* dhe *atëherë* përdoren kryesisht për të realizuar marrëdhënie endoforike. P.sh.: *Për gjashtëdhjetë vjet rresht kishte stolisur gjithë nuset e qytetit. **Tani** s'mund t'i linte.* ("Kronikë në gur", f. 205)

Megjithatë, këto njësi i hasim shpesh edhe si elemente ekzoforike. P.sh.:

- *Kur qëllonte kundërajtori ynë, tundej dheu.*

- *Kur?*

- ***Atëherë**.* ("Kronikë në gur", f. 98)

Në tekstet e Kadaresë referenca realizohet edhe nëpërmjet mbiemrave ose ndajfoljeve që shprehin krahasim të caktuar, të mbështetur në ngjashmëritë ose në dallimet midis elementeve, ose nëpërmjet epiteteve. P.sh.: *Ndërsa ndiqte me sy oficerët e lartë, ai mundohej të gjente epitetet që duhej të vinte pranë emrave të tyre në kronikën e tij, në qoftë se të gjithë ata do të tregoheshin të lavdishëm në luftë. Ata ishin **si një grusht xhevahirësh** që ai duhet ta hidhte me mënçuri mbi gjithë atë ushtri të pafund.* ("Kështjella", f. 243.)

1.3 Lidhshmëria është një nga format e kohezionit gramatikor, e cila për dallim nga format e tjerat "nuk është kohezive në vetvete, por në mënyrë të

*tërthortë, nëpërmjet kuptimeve specifike të elementeve të lidhshmërisë*⁴.¹ Lidhja mund të bëhet me anë të lidhëzave e mjeteve të tjera lidhëse, të cilat jo vetëm që lidhin njësitë, por shprehin edhe marrëdhënie të ndryshme, dhe garantojnë vazhdimësinë gramatikore dhe logjiko-semanticë midis frazave në tekst.

Në tekstet e Kadaresë hasim një laramani të madhe në lidhjen e njësive me lidhëza e mjete të tjera lidhëse, qofshin ato bashkërenditëse apo nënrenditëse. Shumica e fjalive fillojnë me lidhëza, që shprehin raportet e nënrenditjes, por edhe me lidhëza bashkërenditëse, kryesisht shtesore.

Kur tekstet e tij karakterizohen për fjali me një strukturë më të ndërlikuar, me mbizotërim të lidhjes nënrenditëse, ato shquhen për një shkallë të lartë të vijueshmërisë logjike. Ndërkaq, ndërtimet më pak të ndërlikuara, me mbizotërim të bashkërenditjes, i hasim dendur sidomos në sekuencat e dialogut, të cilat shfrytëzohen për t'i dhënë një ritëm më të shpejtë zhvillimit të rrëfimit.

Rrëfimi, që mëton të ndjekë sistematikisht ecurinë e rrjedhës kronologjike të ngjarjeve, është një nga mënyrat më të shpeshta të organizimit të ideve në tekstet e Kadaresë, prandaj shoqërohet me përdorimin e njësive kohezive që janë karakteristike për këtë tip ligjërimi, apo të lidhëzave e lokucioneve lidhëzore që shprehin marrëdhënie kohore, si: *kur, tek, ndërsa, ndërkohë, derisa, posa, pasi, sa kohë që* etj. P.sh.: *Pastaj mori kutinë e pudrës nga tavolina, e hapi përpara robëdashambrin dhe diçka nisi të bënte me sfungjer.*

Kur ajo hoqi robëdashambrin dhe u përkul të merrte ndërresat nga krevati, unë mbylla sytë. **Kur** i hapa, në trupin e saj tantellat dukeshin si ca flutura të bardha që po i uleshin radhë-radhë, në rrëzë të këmbëve, poshtë ijeve, mbi gjoks, si ato fluturat e bardha të fushave që dalin në pranverë dhe që unë i kisha ndjekur shpesh, pa mundur të zë dot kurrë asnjë prej tyre. ("Kronikë në gur", f. 62)

Duke u mbështetur në të gjitha këto tipare, mund të përfundojmë se gjuha e tekstit letrar të Kadaresë, në të vërtetë, ka veçori apo karakteristika gjuhësore të veçanta. Në tekstet e tij raportet gramatikore midis njësive gjuhësore janë të ndryshme e të llojllojshme, e në përputhje me tipat e ligjëritimit.

Ato shquhen për një rrjedhshmëri të qartë, e cila realizohet falë njohurive të autorit për përdorimin e mjeteve, me të cilat realizohet kohezioni.

⁴ Lindita S. Rugova, *Elemente kohezive, tipike për shqipen dhe anglishten*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 27/1, Prishtinë, 2008, f. 129.